



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 53

Prishtinë, më 21.06.2012, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Mungoi- Goran Marinković

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit të Policisë së Kosovës dhe Inspektoratit Policor të Kosovës, rreth mungesës së arit nga dhoma e dëshmime në Drejtorinë Rajonale Policore në Pejë;
3. Shqyrtimi i kërkesës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale lidhur me ngritjen e buxhetit të kësaj Agjencie;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit të Policisë së Kosovës dhe Inspektoratit Policor të Kosovës, rreth mungesës së arit nga dhoma e dëshmime në Drejtorinë Rajonale Policore në Pejë.

Kryetari i Komisionit- Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, ka marrë dy raporte për rastin e vjedhjes në dhomën e dëshmisë në Pejë, njërin nga Drejtoi i Përgjithshëm i Policisë dhe tjetrin nga Kryeshefi i Inspektoratit Policor të Kosovës. Në raportin e Policisë së Kosovës, Drejtori i përgjithshëm i Policisë i referohet drejtpërsëdrejti Inspektoratit Policor të Kosovës.

Në raportin e Inspektoratit Policor theksohet se janë marrë të gjitha masat për identifikimin e aktorëve, gjithashtu theksohet fakti se janë arrestuar katër persona, të cilët janë intervistuar, dhe për njërin është caktuara masa paraburgimit prej tridhjetë ditësh. Pas diskutimit të këtyre raporteve do të nxjerrim një vendim përfundimtar për raportet e dërguara nga Policia e Kosovës dhe Inspektorati Policor në Komision.

Rexhep Selimi- Raporti i Inspektoratit Policor nuk jep shumë informacione për Komisionin Parlamentar, ndërsa në raport kamë vërejtur një përplasje të kompetencash mes Prokurorisë dhe Inspektoratit Policor të Kosovës. Raporti si i tillë mund të interpretohet në dy aspekte, ose Inspektorati Policor nuk ka informacion me të detajuar, ose kjo bëhet për të fshehur nga Komisioni. Gjithashtu masat për hetim janë të kufizuara, përderisa masa të tilla merren vetëm ndaj disa oficerëve, pasi përgjegjëse duhet të jenë edhe hierarkia e lartë e policisë. Gjithsesi kjo nuk e cenon besueshmërinë në Policinë e Kosovës, por vlerësoj se raporti është i mangët.

Kryetari i Komisionit- Edhe në rastin e parë të vjedhjes në Dhomën e Dëshmime në Prishtinë, edhe rasti i vjedhjes në Stacionin Policor në Pejë, kanë dëmtuar imazhin e Policisë së Kosovës. Për të mos ndodhur një gjë e tillë duhet të kërkojmë përgjegjësi institucionale në nivelin më të lartë, nga zinxhiri komandues dhe politika udhëheqëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme të cilat duhet të marrin masa më të rrepta për të mos lejuar veprime të tilla që e dëmtojnë imazhin e Policisë së Kosovës.

Anton Quni- Rasti i vjedhjes në Dhomën e dëshmime, kërcënimi me likuidim të zyrtarëve të Policisë së Kosovës që nuk e respektojnë kodin e heshtjes, hetimet ndaj zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme për keqpërdorim të fondeve dhe përvetësime materiale, e dëmtojnë imazhin Policisë së Kosovës.

Grupi i ekspertëve të Interpolit korrupsionin e përkufizojnë në këtë mënyrë: *pjesëmarrës kryesor, bashkëkryes, iniciues, nxitës, bashkëpunëtor, ndihmës para kryerjes së veprës, ndihmës pas kryerjes së veprës dhe komplotues, quhet korrupsion.*

Shërbimi Policor është agjenci e shtetit nga e cila publiku pret që të kontrolloj sjelljet e të tjerëve, përfshirë edhe zyrtarët e shtetit, dhe nëse publiku nuk i beson policisë, nuk ka ndonjë agjenci tjetër ku të mund të mbështetet për të zbatuar ligjin dhe ruajtur rendin publik.

Jam i mendimit se këto raste janë individuale dhe të izoluara, dhe se shumica e zyrtarëve policor të Policisë së Kosovës janë në nivelin e detyrës dhe punojnë me kod të lartë etik, por heshtja para krimit, sjellja pasive e mekanizmave të kontrollit, inspektimi, auditimit etj., mund ta dekurajoj shumicën e policisë e cila punon me profesionalizëm.

Me këtë rast, nga Ministria e Punëve të Brendshme, përgjegjësit e Policisë së Kosovës kërkoj që të ndërmarrin inspektimet dhe inventarizimet në të gjitha Dhomat e Dëshmive dhe në afatin optimal të vërtetojnë gjendjen. Po ashtu inkurajoj Inspektoratin Policor të Kosovës që në bazë të kompetencave ligjore të intensifikoj veprimet dhe zbardhjen e dukurive kriminale brenda Policisë së Kosovës. Në fund kërkoj nga Komisioni parlamentar, që në agjendën e tij të ketë me prioritet gjendjen brenda institucioneve të sigurisë në Kosovë, posaçërisht Policinë e Kosovës.

Rasti i dorëheqjes për shkak të përgjegjësisë morale i Drejtorit të Policisë Rajonale në Pejë është për tu përshëndetur, këtë akt duhet ta kenë parasysh edhe zyrtarët e tjerë në zinxhirin komandues dhe në nivelin politik.

Fatmir Xhelili- Në këtë periudhë kohore raporti i Inspektoratit Policor nuk përmban shumë informacione, kjo mbasi është në fazën e hetuesisë dhe nuk mund të ofroj elementë më shumë se sa janë të pranishëm. Është e vërtetë që në Policinë e Kosovës akoma nuk është instaluar institucioni i përgjegjësisë, në formën se si e kërkojnë rregulloret e policisë për punën e zyrtarëve policor dhe përgjegjësitë e tyre.

Në periudhën 2008-2009 ka përfunduar procesi i inventarizimit në Policinë e Kosovës. Duke qenë pjesë e këtij procesi kemi insistuar që inventarizimi të përfundoj dhe për këtë qëllim shteti ka investuar për një program të sofistikuar që inventarizimi me qenë në sistemin e teknologjisë informative, në mënyrë që çdo punëtor të ketë qasje dhe çdo pajisje e policisë të identifikohet si pronë e policisë.

Pas vjedhjes së parë që ka ndodhur në Policinë e Kosovës, kam propozuar që inventarizimi të bëhet edhe në dhomën e dëshmive si në qendër në Drejtorinë e Krimeve të Rënda ashtu edhe në Drejtorinë Regjionale. Duhet ditur që pronar i të gjitha evidencave dhe dëshmive që ruhen në Dhomat e Dëshmive në Policinë e Kosovës është Prokuroria, ndërsa përgjegjës për ruajtjen e tyre është Polica. Kjo formë e ruajtjes së provave është zgjedhur nga shteti ynë me propozimin e UNMIK-ut, që provat materiale të ruhen në Polici. Rasti i tillë që ka ndodhur me vjedhjen në dhomën e dëshmive, e ka

zbehur imazhin e policisë dhe kjo si rezultat i papërgjegjësisë së disa zyrtarëve të përfshirë në aktivitete të tilla kriminale.

Propozoj Komisionit që në kuadër të mbikëqyrjes së funksionimit të Policisë së Kosovës, ti propozojmë Policisë së Kosovës formimin e një Komisioni të jashtëzakonshëm që të bëjë evidentimin e të gjitha provave, në mënyrë që të dihet saktë se çfarë posedon Policia e Kosovës në Dhomat e Dëshmive. Regjistrimi i tillë është dashur të bëhet në fund të çdo viti dhe kjo ka qenë e obligueshme në mënyrë që të bëhej krahasimi se prej cilit moment ato prova mungojnë.

Pas punës së këtij Komisioni, mbikëqyrja nga ana e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së do të ishte më e lehtë, gjithashtu edhe nga ana e Inspektoratit Policor i Kosovës. Rekomandoj Komisionit që të insistojmë në përgjegjësi të dyanshme, në aspektin procedural obligime të cilat nuk janë përmbushur, kjo në mënyrë që Prokuroria dhe hetuesi të zhvillojnë hetime serioze.

Policia e Kosovës ka kuadër të mjaftueshëm për zhvillimin e hetimeve por, ndihma nga policitë e tjera siç është EULEX-i do të ndihmonte në këtë aspekt, në mënyrë që në rast se ka pengesa në Policinë e Kosovës të evitohen mangësitë e qëllimshme ose jo të qëllimshme për zbardhjen e rasteve.

Propozoj Komisionit që ndër rekomandimet kryesore të jetë formimi i një Komisioni për evidentimin dhe regjistrimin e provave dhe evidencave në dhomat e dëshmive.

Vjollca Krasniqi- Krahas obligimeve në shtrirjen e rendit dhe ligjit në veri të vendit dhe përmbushjes së obligimeve që dalin nga udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave, Ministria e Punëve të Brendshme përballlet me veprime të ulëta nga punonjësit e saj si dhe nga radhët e zyrtarëve policor.

Raporti nga ana e Inspektoratit Policor për vjedhje në Dhomën e Dëshmive në Stacionin Policor të Pejës, është i mangët dhe nga kjo informatë nuk mund dimë më shumë, por aq sa jemi informuar nga media. Përderisa nuk zbardhet rasti i vjedhjes që ka ndodhur në vitin 2009 në dhomën e dëshmive, kjo do të shërbente si stimulim për përsëritje e veprimeve të tilla. Sado që Komisioni bën përpjekje për ruajtjen e imazhit të Policisë së Kosovës, një gjë e tillë nuk ndodh në këtë organizatë.

Kryetari i Komisionit- Nga konstatimet që dolën nga ky takim, pajtohem që nga Policia e Kosovës të krijohet një Komision i cili bën vlerësimin, inventarizimin dhe sigurimin më të madh të dhomave të dëshmive në nivel të Kosovës.

Veprimet që ndodhin brenda Policisë së Kosovës të bëjnë të dyshosh, prandaj si Komisioni dalim me konstatimin që brenda Policisë së Kosovës të formohet Komisioni i cili do të garantoj mbrojtjen e Dhomave të Dëshmive dhe elementeve të tjera të obliguara me ligj. Gjithashtu kërkojmë nga Prokuroria, Gjykatat që të ndërmarrin veprime në mënyrë që të nxirren para ligjit të gjithë ata që kanë bërë veprime jo ligjore, kanë dëmtuar imazhin e Policisë së Kosovës.

Mendoj se është koha për një përgjegjësi më të lartë institucionale në kuadër të Qeverisë, zinxhirit komandues të Policisë së Kosovës, pasi gjendja është e pa tolerueshme në mënyrë që të ngritët niveli i përgjegjësisë në institucionet e Kosovës.

Si Komision, me rekomandimet e paraqitura do ti drejtohem Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe do të kërkojmë që të zbatohet ligji nga institucionet që kanë përgjegjësi para ligjit.

Fatmir Xhelili- Propozoj që të caktohen afate kohore për Komisionet e propozuara, në mënyrë që ato të obligohen ti kryejnë regjistrimet e jashtëzakonshme në Dhomat Dëshmive. Gjithashtu propozoj që si Komision të propozojmë që edhe Prokuroria të përfshihet në këtë proces, për të seleksionuar dëshmitë për të cilat ka përfunduar proceset gjyqësore. Gjatë seleksionimit Prokuroria për dëshmitë që kanë vlerë materiale dhe financiare, të merr vendim që ato të kalojnë në Agjencinë për Konfiskimin e Pasurisë. Rekomandim për Inspektoratin Policor të Kosovës, që të bëjë një inspektim të jashtëzakonshëm dhe të propozoj masat e sigurisë për dhomat e dëshmive dhe kërkimin e përgjegjësisë për realizimin në afat kohor të masave të sigurisë nga Policia e Kosovës.

Propozoj që afati kohor për regjistrimin në Dhomat e Dëshmive të jetë një muaj në tre drejtime, për Inspektoratin Policor për propozimin e masave të sigurisë, për Policinë e Kosovës për krijimin e Komisionit dhe regjistrimin e evidencave dhe për Prokurorinë për të bërë seleksionimin e provave materiale që kanë vlerë financiare, dhe respektimi i parimeve të shkatërrimit të provave pas përfundimit të proceseve gjyqësore.

Rexhep Selimi- Pajtohem me ndërmarrjen e masave të sigurisë në Dhomat e Dëshmive, por kjo nuk do të thotë që të shpëtojmë nga ajo që ka mbetur nga provat në këto dhoma. Megjithatë nga gjithë ajo çfarë u tha këtu mund të bënim në një raport për Inspektorin e Policisë dhe përfaqësuesit e Policisë së Kosovës.

Do të ishte mirë që ti kishim në raportim të drejtpërdrejtë përgjegjësit kryesor, por kjo nuk duhet kuptuar që jemi pajtuar me gjendjen, por të jemi të fokusuar që drejtësia të vihet në vend, duke marr masat hetimore nga Prokuroria, por kjo nuk do ta shkarkonte nga përgjegjësia zinxhirin komandues policor dhe politik.

Kryetari i Komisionit- Propozoj që rekomandimet e dala nga ky takim për Policinë e Kosovës të shkojnë në formën e shkruar, ti jepet një muaj afat Inspektoratit Policor të Kosovës për kryerjen e obligimeve, njëkohësisht Prokuroria, Gjykatat të kryejnë detyrën konform dëmit që i është bërë nivelit institucional të Kosovës.

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime nxori këto:

REKOMANDIME

Ti dërgohen në formë të shkruar rekomandimet Policisë së Kosovës, tutje i rekomandohet Policisë së Kosovës, formimi i një Komisioni të jashtëzakonshëm që të bëjë inventarizimin, regjistrimin e të gjitha provave në dhomën e dëshmive brenda një afati një muhor.

Inspektoratit Policor të Kosovës ti jepet afati një muhor për kryerjen e obligimeve ligjore dhe propozimin e masave të sigurisë për Policinë e Kosovës, si dhe Prokurorisë dhe Gjykatave të kryejnë detyrat në bazë të ligjit.

Me këtë rekomandim e konsideroi të mbyllur këtë pikë të rendit të ditës dhe kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale lidhur me ngritjen e buxhetit të kësaj Agjencie;

Kryetari i Komisionit- Nga takimi që kam pasur me Drejtorin e Agjencisë, z. Ruzhdi Jashari, janë shqetësues parametrat e ofruar për buxhetin e Agjencisë, të cilët kanë shënuar rënie në vend të ngritjes së tyre për nevojat e Agjencisë. Në Raportin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili është diskutuar në Komision, është parë një punë e mirë e tyre.

Për këtë arsyeje në emër të Komisionit, të bëjmë një raport drejtuar Kuvendit të Kosovës, Qeverisë së Kosovës, në mënyrë që Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të ketë një buxhet më të madh, pasi kjo Agjenci është e vendosur në objekt privat dhe që duhet të kaloj në objekt publik, Agjencia gjithashtu e ka numrin e vogël të punonjësve në krahasim me nevojat që ka. Për këtë arsyeje nëse pajtoheni mund të bëjmë një raport të tillë dhe nëse ka propozime nga anëtarët e Komisionit mund ti shtojmë në raport.

Fatmir Xhelili- Është evidente që mjetet financiare për funksionimin e Agjencisë janë të mangëta. Përkrahë propozimin me kushtin që të evitohet pagesa e qerasë dhe gjetja e objektit institucional, në mënyrë që këto fonde të përdorën për nevojat e Agjencisë.

Rexhep Selimi- Gjatë vizitës që kemi bërë në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave, kemi kuptuar që është në një fazë fillestare të rëndësishme të punës dhe mbështes idenë që duhet të jetë më e përkrahur financiarisht, për shkak të nevojave që ka. Gjithashtu mbështes idenë që duhet transferuar në objekt publik në mënyrë që buxheti të menaxhohet në mënyrë të arsyeshme, ndërsa për zgjidhjen e problemeve financiare do të përkrahen nga Komisioni si dhe nga grupet parlamentare, në mënyrë që të ndikohet në rishikimin e buxhetit dhe të ketë një rritje të buxhetit për Agjencinë.

Kryetari i Komisionit- Me rekomandimet për Kuvendin e Kosovës, Qeverisë së Kosovës, që Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të ketë buxhet më të madh dhe të kaloj në objekte institucionale, e konsideroj të mbyllur këtë pikë të rendit të ditës.

4. Të ndryshme.

Kryetari i Komisionit- Nga takimi i kaluar është vlerësuar se duhet të kemi një takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme për Ligjin për Gjuetinë dhe Ligjin për Armët, të cilat duhet harmonizuar. Për këtë qëllim është paraparë një dëgjim publik i cili do të mundësonte një harmonizim të dy ligjeve, pas ankesave të ardhura nga Federata e Gjuetarëve, në mënyrë që të merret vendim për ndryshimin e gjendjes ekzistuese. Ky takim është paraparë të jetë në javën e ardhshme.

Çështja tjetër ka të bëjë me vizitën e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së në Turqi. Vizita planifikohet që të jetë në fillim të muajit korrik. Nga kjo vizitë do të vizitohen institucionet e fushës së sigurisë, ushtrinë turke, policinë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, në mënyrë që të merren përvoja të dobishme për institucionet e sigurisë në Kosovë, si dhe kontakti i drejtpërdrejtë me Komisionin për Siguri dhe Mbrojtje të Turqisë.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi